

---

RAPORT STUDIMOR

2023

---

# HETIMET DHE SANKSIONET ADMINISTRAT IVE TË KQZ-SË

---



**RAPORT STUDIMOR MBI HETIMET DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE TË  
KQZ-SË**

*Gjatë procesit të zgjedhjeve vendore të dt. 14 maj 2023*

*Publikuar në Qershor 2024*

1. Përpunimi dhe analiza e të dhënave sasiore:

**Znj. Xhesika Shameti, Eksperte e jashtme junior, Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

2. Analiza cilësore e vendimmarrjeve dhe të dhënave sasiore:

**Znj. Ardita Kolmarku, Menaxhere Projektsh/Drejtuese e Klinikës së Ligjit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

3. Mbikëqyrën dhe rishikuan:

**Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

**Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

*Ky raport është hartuar në kuadër të nismës “Ndërtimi i integritetit elektoral dhe qëndrueshmërisë së partive politike: Rritja e rolit mbikëqyrës dhe kërkesave të qytetarëve nëpërmjet mbështetjes së OShC-ve, mediave dhe akademisë”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në partneritet me Instituti i Studimeve Politike, Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania, mbështetur financiarisht nga Ambasada Britanike në Tiranë.*

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.**

**Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

**Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike në Tiranë.**

**Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt”**

**Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania**

**Kutia Postare nr.1752**

**Tel: 04 2233671**

**Cel: +355 69 40 75 732**

**E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)**

**Web site: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)**

## Tabela Përmbledhëse

<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....</b>	<b>5</b>
<b>1 HETIMET ADMINISTRATIVE Të KQZ-Së .....</b>	<b>12</b>
1.1 Procedura e ndjekur gjatë hetimit administrativ nga KQZ .....	12
1.2 Kategoritë e “denoncuesve” dhe “objekti i denoncimeve” pranë KQZ-Së .....	14
1.2.1 Kërkesë\ankesat e depozituara nga subjektet zgjedhore	17
1.2.2 Kërkesë\Ankesat e depozituara nga palët e treta	18
1.2.3 Hetimi administrativ kryesisht ( <i>ex officio</i> ) nga ana e KQZ	19
1.2.4 Kërkesat/Ankesat nga Sinjalizuesit	21
1.3 Palët e treta të interesuara në cilësinë e denoncuesit.....	22
1.4 Bashkëpunimi ndërmjet KQZ dhe organeve publike .....	26
1.5 Niveli i respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë seancës dëgjimore publike.....	27
1.6 Ndërveprimi i KQZ-së gjatë procedimit administrativ në funksion të procesit të të provuarit .....	28
1.7 Heqja dorë nga ankimi .....	28
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>30</b>

## **HYRJE**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (në vijim “KShH”) në cilësinë e një organizate joqeveritare dhe jofitimprurëse, prej vitit 1996, ka monitoruar proceset zgjedhore të mbajtura në vendin tonë. Modestisht, KShH ka kontribuar në garantimin e zhvillimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Sensibilizimi i qytetarëve për të drejtën e votës dhe çështjet zgjedhore me rëndësi është një nga parakushtet për zgjedhjet e lira dhe të ndershme. KShH vëren se nga njëri proces zgjedhor në tjetrin, dialogu i aktorëve të shoqërisë civile me institucionet është rritur, duke synuar dobësimin e monopolizimit të reformimit zgjedhor nga faktorët politikë.

Nëpërmjet këtij Raporti Studimor të një natyre të veçantë, KShH ka analizuar në mënyrë të pjesshme rreth 46 vendime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, 121 vendime të KAS dhe 2 vendimmarrje të Rregullatorit, të disponuara gjatë periudhës nga momenti i dekretimit të zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore të dt.14 Maj, nga Presidenti i RSH, përkatësisht gjatë periudhës Tetor 2022 - Qershor 2023.

Nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve të adresuara nga ana e KShH-së, synohet analizimi i vendimmarrjeve të KQZ-së mbi denoncimet dhe kërkesat ankimore me natyrë administrative, të depozituara si nga ana e subjekteve zgjedhore, ashtu dhe nga palët e treta.

Në fokus të veçantë të këtij raporti studimor është analiza e KShH-së mbi respektimin e standarteve themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga organet drejtuese të KQZ-së, të tillë si pavarësia, paanshmëria, e drejta për t’u dëgjuar.

Versioni draft i këtij Raporti Studimor u konsultua në një tryezë të përbashkët të organizuar me 27 Mars 2024, me përfaqësues të KAS, Komisionit Rregullator, Kolegjit Zgjedhor, ekspertë të fushës, si dhe aktorë të shoqërisë civile e media. Komentet e sugjerimet e adresuara u vlerësuan objektivisht, në përputhje me lirinë e organizimit të KSHH-së dhe pavarësinë e saj të brendshme e të jashtme, u vlerësuan objektivisht.

Hartimi i këtij raporti studimor është bazuar në analizën e vendimmarrjeve, procesverbaleve të mbledhjeve, njoftimeve të publikuara në faqen zyrtare dhe regjistrimet audio-vizuale në kanalën e dedikuar të Youtube të KQZ-së, si organi më i lartë i administrimit zgjedhor që pasqyrojnë veprimtarinë dhe funksionimin e organeve drejtuese të tij në periudhën parazgjedhore, ditën e zgjedhjeve dhe pas zgjedhore të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të dt.14 Maj 2023.

Analiza në këtë raport studimor është realizuar në përputhje me metodologjinë dhe pyetësonin e dedikuar të monitorimit të KQZ-së, i cili ka orientuar ekspertët pjesë e grupit të punës për të analizuar objektivisht e në mënyrë të gjithanshme praktikatat dhe vendimmarrjet e KQZ-së lidhur me kërkesë/ankesat e adresuara nga ana e subjekteve zgjedhore, palët e treta si dhe rastet e hetimeve administrative të iniciuara *ex officio/kryesisht*.

Në Raportin Përfundimtar të Monitorimit të Procesit Zgjedhor për organet e qeverisjes vendore,<sup>1</sup> OSBE/ODIHR vuri theksin në transparencën dhe efikasitetin e punës së KQZ-së në tërësi. Sipas këtij raporti, interpretimi formal në mënyrë të ngushtë mbi zbatueshmërinë e dispozitës që vendosi masa mbrojtëse ndaj shpërdorimit të burimeve shtetërore vetëm për zgjedhjet parlamentare dhe jo ato vendore,<sup>2</sup> tërhoqi vëmendjen e KShH-së. Gjithashtu, ky mision konstatoi se disponimi i vendimmarrjeve kontradiktore të KAS, të cilat nuk i shërbejnë qëndrueshmërisë e sigurisë juridike të normës ligjore, impaktoi efektivitetin juridik të problematikave të ngritura nga ana e subjekteve.<sup>3</sup>

Nga monitorimet e realizuara nga KShH, nëpërmjet rrjetit të korrespondentëve dhe vëzhguesve të tij në terren, është konstatuar se fushata zgjedhore ka filluar para afatit ligjor të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor, pra më herët se data 14 Prill 2023 e cila përkon me afatin 30 ditë para datës së zgjedhjeve. Konkretisht, u raportuan nga KShH zhvillimi i takimeve elektorale nga ana e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, ndërkohë që nuk kanë munguar postimet e ndryshme në rrjetet sociale të përdorura si kanale komunikimi të Ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera. Pavarësisht se raste sporadike që i përkasin periudhës së fushatës së parakohshme zgjedhore janë bërë publike edhe në media, është konstatuar një qasje tolerante dhe mos ndëshkuese nga ana e KQZ-së. Në vlerësimin e KShH, masa në raste të tilla flagrante, të përsëritura, mund të ishin sanksionuar në frymën dhe zbatimin e nenit 172 pika 1 KZ.<sup>4</sup> Është

---

<sup>1</sup> <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2023/09/Raporti-Perfundimtar-per-Monitorimin-e-Zgjedhjeve-19-Shtator-2023.pdf>

<sup>2</sup> Fq. 2 e Raportit Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, <https://ëëë.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>

<sup>3</sup> Konstatim i ngjashëm evidentohet nga ana e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR. Fq. 3 e raportit, idem.

<sup>4</sup> Neni 72/1 i KZ përcakton se: “1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes

qartësisht e evidentueshme se fushata në një periudhë rreth 3 mujore para datës së përcaktuar në nenin 77 të KZ shoqërohet me shpenzime të shumta, duke krijuar pabarazi në garën që duhet të jetë e ndershme ndërmjet subjekteve zgjedhore.

Situata në çënim të Kodit Zgjedhor dhe akteve rregullatore të KQZ-së janë konstatuar edhe gjatë fushatës zgjedhore. Nëpërmjet 3 vendimmarrjeve të tij, Komisioneri Shtetëror ka vlerësuar raportet e monitoruesve të fushatës zgjedhore, gjatë periudhave 7 mars – 2 maj<sup>5</sup>, 2 maj – 8 maj<sup>6</sup>, 9 maj – 10 maj<sup>7</sup>, të vitit 2023. Nga të dhënat e pasqyruara në këto raporte konstatohet afishimi i materialeve propagandastike nga ana e subjekteve zgjedhore në kundërshtim me këto parashikime, në vijim të të cilave janë urdhëruar përfaqësues të agjencive ligjzbatuese për heqjen e menjëhershme të tyre si dhe mbylljen e zyrave zgjedhore të hapura në një distancë më të vogël se 300 m nga vendndodhja e selive të administratës vendore zgjedhore. Shkelje të tilla janë të përsëritura nga njëri proces në tjetrin zgjedhor, të cilat reflektojnë në vlerësimin e KShH-së mungesë ndërgjegjësimit dhe kulture, për të garuar në mënyrë të ndershme dhe të barabartë.

Në raport me organizatat e shoqërisë civile, të cilat në jo pak raste proaktivisht kanë luajtur rolin e palës së tretë duke adresuar ankesa e denoncime të ndryshme të natyrës administrative, Komisioneri Shtetëror ka reflektuar një qasje bashkëpunuese dhe të hapur. KShH vlerëson si pozitiv numrin e denoncimeve dhe ankesave të përcjella nga këta aktorë të pavarur dhe të paanshëm të shoqërisë civile, si dhe qasjen e treguar nga KQZ për të respektuar të drejtat e tyre si palë në procesin e shqyrtimit administrativ, si dhe pjesëmarrjen e tyre në seancat dëgjimore në kuadër të shqyrtimit të këtyre ankesave. Vlen të theksohet se disa prej vendimmarrjeve të disponuara pas hetimit të këtyre denoncimeve, kanë shërbyer në krijimin e praktikave pozitive dhe unifikimin e mëtejshëm të trajtimit të rasteve. Përpos dinamikës dhe ngarkesës me të cilën përballet administrata e KQZ-së në përgatitje dhe gjatë procesit zgjedhor, KShH vlerëson se sistemi i trajtimit të ankesave/denoncimeve duhet të forcohet me qëllim garantimin e standarteve më të mira për hetime efektive në afate të arsyeshme, objektive dhe të gjithëanshme. Ky rekomandim, në mënyrë të veçantë merr shkas nga fakti se KShH nuk ka ende një përgjigje zyrtare nga KQZ mbi trajtimin e tre denoncimev administrative që ka përcjellë, sikurse janë ankesa e sekretares së KZAZ nr. 24 në Durrës,<sup>8</sup> aktiviteti inagurues i

---

dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë.”

<sup>5</sup> Vendim nr. 452, datë 6.5.2023, “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri më 2 maj 2023”. Link: <https://kqz.gov.al/akte-te-kqz-2/>

<sup>6</sup> Vendim nr. 482, datë 10.5.2023 “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 2 maj deri më 8 maj 2023”. Link: <https://kqz.gov.al/akte-te-kqz-2/>

<sup>7</sup> Vendim nr. 496, datë 11.5.2023 “Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 9 maj deri më 10 maj 2023”. Link: <https://kqz.gov.al/akte-te-kqz-2/>

<sup>8</sup> Shkresa nr. prot. 354, dt. 13 maj 2023 (përcjellë elektronikisht) "Përcillet sinjalizimi i bërë me dije nga ana e Sekretares së KZAZ nr. 24 (Durrës)"

Piramidës së Tiranës si një veprimtari e ndaluar<sup>9</sup>, si dhe keqpërdorim i burimeve shtetërore gjatë fushatës zgjedhore ë organizuar pranë Bashkisë Lezhë.<sup>10</sup>

Në kuptim të rëndësisë që ka transparenca dhe mbikqyrja publike, ku përfshihet edhe realizimi i këtyre raporteve studimore nga organizatat e shoqërisë civile, paraqet pengesë objektive mungesa e publikimeve në kohë e procesverbaleve të mbledhjeve të zhvilluara nga KQZ.

KShH vlerëson se në zgjedhjet e ardhshme është e nevojshme të rritet pro-aktiviteti i KQZ-së në fillimin e hetimeve administrative me nismën e tij, konform parashikimeve ligjore të neneve 77, 78, 80 dhe 88 të KPA. Këto dispozita vlejnjë gjithashtu të harmonizohen e të gjejnjë rregullim ligjor të veçantë në Kodin Zgjedhor të RSH-së.

Rritje e rolit proaktiv të KQZ-së është e domosdoshme të shihet edhe në referimin apo denoncimin penal të fakteve që mund të hetohen në prokurori, sikurse janë rezultatet e auditimeve të shpenzimeve financiare dhe financave të partive politike.

Gjatë këtij procesi zgjedhor, është pozitiv fakti që ka patur më shumë hetime administrative nga KQZ, si rrjedhojë e sinjalizimeve lidhur me veprimtaritë e ndaluara dhe shpërdorimin e aseteve dhe burimeve shtetërore, në kundërshtim me parashikimet ligjore të Kodit Zgjedhor dhe akteve rregullatore të KQZ-së. Megjithatë, KShH vlerëson se, në zbatim të nenit 281/3 të Kodit të Procedurës Penale, KQZ duhet të referonte pranë Prokurorisë çështjet që kishin elements të përgjegjësië penale që kanë të bëjnë me shpërdorimin e aseteve publike. Në asnjë rast nuk është përmbushur ky detyrim ligjor.

KQZ ka informuar KShH-në se gjatë periudhës Janar 2023 deri më 10 Mars 2023, janë depozituar në masë denoncime nga ana e aktorëve të shoqërisë civile, e më konkretisht nga organizatat KRIIK dhe Qëndresa Qytetare, ndjekur nga denoncimet e bëra nga subjektet politike dhe në 2 raste denoncues kanë qenë sinjalizuesit anonim. Numri është rritur ndjeshëm gjatë periudhës 10 Maj 2023 deri më 30 qershor 2023, në të cilën janë depozituar në total 294 denoncime. Gjatë periudhës 10 Mars – 30 Qershor 2023, evidentohet se Komisioneri Shtetëror ka kryer hetim *ex officio* në 8 raste të inicuar nga monitoruesit e kontraktuar nga KQZ, dhe 7 raste janë përcjellë nga sinjalizues.<sup>11</sup>

Sa i përket objektit të denoncimeve të adresuara rezultojnjë që ato të jenë adresuar më së shumti për ‘mosraportim të aktivitetit para datës së raportimit’ ndjekur nga denoncimet me objekt ‘shpërdorim i burimeve publike dhe burimeve njerëzore’ Në një masë të reduktuar janë regjistruar denoncime me objekt ‘keqinformimi nga ana e subjekteve mediatike’<sup>12</sup>. Në analizë të disa prej vendimmarrjeve të shqyrtuara lind nevoja për motivim më të mirë të

---

<sup>9</sup> Shkresa nr. prot. 357, dt. 13 maj 2023 “Përcillet sinjalizim për një veprimtari publike të ndaluar në Bashkinë Tiranë”.

<sup>10</sup> Sinjalizim përcjellë elektronikisht nëpërmjet email të dt. 10.05.2023, ora 8:53 AM

<sup>11</sup> Shkresë nr. 6057/1 prot., dt. 30.06.2023 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

<sup>12</sup> Nenet 84 dhe 85 KZ dhe vendimi nr. 2, dt. 30.01.2021



vendimmarrjeve lidhur me këto denoncime, si në rastet kur kërkesat ankimore janë pranuar nga KAS por veçanërisht kur ato refuzohen.

Në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor, hetimi administrativ kryhet nga administrata e KQZ-së, ndërkohë që propozimi për sanksione mbetet atribut i Komisionerit. është KAS që ka të drejtën e vendimmarrjes, për çështjet e përcjella prej tij. Në përgjithësi, nga kampionimi i vendimmarrjeve të analizuara në këtë raport, KShH ka konstatuar se hetimi administrativ i ndërmarrë nga KQZ ka qenë i plotë, e është ndërmarrë në përputhje me standartet e procesit të rregullt ligjor. M gjith, vlen të nënvizohet se pretendimet e ngritura nga ana e subjekteve denoncuese, është e udhës që të hetohen në mënyrë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse, duke u reflektuar në pjesën arsyetuese të vendimmarrjes. Kjo praktikë do t'i shërbejë gjithashtu forcimit të mëtejshëm të pavarësisë dhe paanshmërisë së organeve drejtuese të KQZ-së si dhe pasurimit dhe qëndrueshmërisë së praktikës vendimmarrëse të KAS.

Me qëllim që të realizohet një hetim administrativ proaktiv, transparent dhe efikas në kuptim të cilësisë dhe kohës, është e sugjerueshme marrja e masave për ngritjen e një strukture të specializuar pranë KQZ-së, e pajisur me burime njerëzore të mjaftueshme dhe të specializuara. Rrjedhimisht, kjo do të kontribuonte në drejtim të rritjes së besueshmërisë së subjekteve dhe publikut ndaj KQZ-së, institucionit më të rëndësishëm që përfaqëson organin më të lartë të administrimit zgjedhor.

Në disa çështje, Komisioneri ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ, duke pamundësuar mbylljen e hetimeve administrative brenda afatit 60 ditor të përcaktuar në vendimin përkatës të Komisionit Rregullator. Veçanërisht kjo është konstatuar në periudhat gjatë cilave volumi i procedurave dhe çështjeve të tjera të administrimit zgjedhor nga KQZ ka qenë i shtuar. Referuar afateve të kërkesave ankimore në KAS, rezulton se është respektuar afati i shqyrtimit prej 10 ditësh, sipas vendimit përkatës të Komisionit Rregullator.

Nga ana e KAS, gjatë konsultimit të këtij raporti, u mbajt qëndrimi se diskrecioni i këtij organi drejtues, përbërës të KQZ-së për realizimin e hetimit administrativ është i kufizuar. Në vlerësimin e KShH-së, në zbatim të neneve 136 pika 2 dhe 137 pika 1 të K.Pr.Administrative, KAS në cilësinë e organit vendimmarrës për shqyrtimin e kërkesave ankimore apo çështjeve të adresuara nga ana e Komisionerit, mund të ndërmarrë hetime shtesë në rast se konstaton se organi propozues nuk i ka kryer ato në mënyrë të plotë. Në tërësi, KShH vlerëson se pyetjet dhe kërkesat e anëtarëve të KAS kanë kontribuar pozitivisht në drejtim të marrjes së informacionit të nevojshëm për hetimin administrativ dhe marrjes së provave që i shërbejnë thellimit të mëtejshëm të tij.

Përkundrejt nevojës për paanshmëri dhe objektivitet përgjatë procedurës së shqyrtimit në KAS, në raste të veçanta, diskutimet ndërmjet anëtarëve të tij dhe Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, sa i përket masave administrative të kërkuara për t'u vendosur ndaj Policisë Bashkiake kishin natyrë “udhëzuese”. Ndërsa prej fillimit të procesit nga ana e përfaqësuesit të

administratës së KQZ-së u kërkua shtyrja e afatit të shqyrtimit administrativ, në përfundim u operua me “sugjerimin” e KAS për pushimin e vendimmarrjes administrative.<sup>13</sup>

Gjatë periudhës pazgjedhore, nga dt.15 Maj deri në fund të muajit Qershor 2023, KAS ka marrë vendim për 68 kërkesa ankimore të depozituara kryesisht nga subjektet zgjedhore<sup>14</sup>. Vetëm në 1 rast, KAS vendosi pranimin e kërkesës dhe vendosjen e sanksionit administrativ ndaj subjektit të denoncuar, ndërsa në 2 raste vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesës për sanksionimin me gjobë të përfaqësuesve të Bashkisë.

Për çështje të rëndësishme vlen të theksohet se KAS ka mbajtur qëndrime të unifikuara, pasqyruar nëpërmjet vendimmarrjeve unanime, ndërkohë që në raste të veçanta anëtarët në pakicë apo me mendime paralele kanë publikuar mendimin e tyre, i cili është bërë pjesë e vendimit përfundimtar të shpallur. Në një nga këto vendime, tërheq vëmendjen mendimi në pakicë i cili nxjerr në pah se refuzimi i kërkesës për njohje apo marrjen e provave shtesë, nuk i ka shërbyer hetimit të gjithanshëm e objektiv, me qëllim promovimin e transparencës së procesit zgjedhor.<sup>15</sup>

KShH vlerëson pozitivisht monitorimin proaktiv që administrata e KQZ-së i ka realizuar ndërfaqes së raportimeve të veprimtarive publike prej autoriteteve përgjegjëse. Qëndrimi i mbajtur nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ndalimin e këtyre veprimtarive përbën një praktikë pozitive që i shërben ndërgjegjësimit të personave përgjegjës kundrejt respektimit të dispozitave ligjore dhe akteve rregullatore të KQZ-së për këtë qëllim.

Pavarësisht vendimmarrjes “precedent” me rëndësi të KQZ-së për ndalimin e postimeve apo ripostimeve në rrjetet sociale të një institucioni publik, të aktiviteteve të cilat pasqyrohen në profilin personal të drejtuesit të institucionit publik, KShH vërejti me shqetësim se ky standart nuk i shërbeu parandalimit të shkeljeve të njëjta apo të ngjashme që u kryen në vijimësi. Në këtë vështrim lind nevoja për fuqizim të kapaciteteve të KQZ-së për monitorimin efektiv të hapësirës teknologjike e rrjetet sociale të subjekteve zgjedhore, kandidatëve përgjegjës dhe aktorëve institucionalë.

Gjatë periudhës objekt monitorimi janë konstatuar raste të mungesës së bashkëpunimit nga ana e organeve publike të përfshira në hetimin administrativ, çka nuk i ka shërbyer pozitivisht parimeve të mbrojtura nga Kodi i Procedurave Administrative si parimi i ligjshmërisë, parimi i transparencës dhe parimi i drejtësisë dhe paanësisë. Në këto raste, KShH vlerëson se KQZ duhet të zbatonte nenin 169 të KZ, duke ndëshkuar me gjobë zyrtaret e organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore që nuk bashkëpunuan. Nga ana tjetër, në disa raste, ankuesit ose denoncuesit ka treguar një qasje jo bashkëpunuese në raport me KQZ-në, duke mos u paraqitur

---

<sup>13</sup> Procesverbal i datës 15 Maj 2023, që i korrespondon vendimit nr. 112 të KAS.

<sup>14</sup> Në pjesën më të madhe e më konkretisht në 24 raste, KAS vendosi pranimin për shqyrtim të mëtejshëm administrativ të kërkesës. Në 9 raste, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore. Në 11 raste, u vendos pushimi i shqyrtimit të kërkesës ankimore. Ndaj 10 kërkesave ankimore, KAS vendosi rrëzimin e tyre e lënien në fuqi të vendimmarrjeve të KZAZ-së për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve.

<sup>15</sup> Vendim nr. 148, datë 26.05.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 82, datë 23.05.2023 të depozituar nga koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’”.

gjatë shqyrtimit administrativ gjyqësor e duke mos përcjellë prova për mbështetjen e pretendimeve apo prova shtesë brenda afatit të lënë në dispozicion për plotësim, ose duke hequr dorë nga shqyrtimi i kërkesës ankimore.

Nga monitorimi i vendimmarrjeve të disponuara, KShH vëren se nuk është bërë e mundur konsolidimi dhe harmonizimi i praktikës (në rastin e vendimmarrjes së KAS), lidhur me masën e gjobës në rastet e shkeljeve me natyrë administrative, me qëllim që gjobat e dhëna të jenë të drejta dhe proporcionale, në përputhje me natyrën dhe pasojat e shkeljes. Në zbatim të neneve 171 dhe 172 të KZ, sanksionet administrative të parashikuara variojnë ndërmjet një marzhi minimal prej 1,000 lekë deri në maksimumi 500,000 lekë, për këtë të fundit kur subjektet zgjedhore janë cënues të dispozitave ligjore. Në mungesë të një përcaktimi të drejtë dhe proporcional të sanksionit në raport me shkeljen, KShH vlerëson nevojën për rishikimin e këtyre dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Për sanksionimin me gjobë të rasteve të shpërdorimit të aseteve publike apo burimeve njerëzore për qëllime zgjedhore, vërehet vështirësi ndërmjet përcaktimit të saktë të termave “përdorim” dhe “shpërdorim” të parashikuara në nenin 91 të KZ. Në fakt në këtë dispozitë elaborohet vetëm koncepti i “përdorimit të burimeve publike” dhe “jo i shpërdorimit”. Bazuar në nenin 118 të Kushtetutës, koncepti i aktit nënligjor është i lidhur me qartësinë e ligjit. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, akti nuk duhet të plotësojë vakumin ligjor por të dalë në zbatim të ligjit. Si rrjedhojë, KShH i sugjeron Kuvendit të analizojë kuadrin ligjor dhe praktikën më të mira të vendeve të tjera dhe praktikën e mira ndërkombëtare, me qëllim ndryshimin e nenit 91 KZ në favor të qartësisë së tij.

Vlen të theksohet se përcaktimi i kundravajtjeve administrative në mënyrë shteruese në Kodin Zgjedhor mund të jetë pengues, si rrjedhojë e përsosjes së vazhdueshëm të shkeljeve të legjislacionit zgjedhor. Kjo nënkupton që duhet ruajtur një balancë midis qartësisë dhe fleksibilitetit që Kodi Zgjedhor duhet të garantojë për tu përshtatur me zhvillimet.

Në rastin e publikimit në rrjete sociale të Agjencisë së Medias dhe Informimit (MIA) institucion në varësi të drejtpërdrejtë të kryeministrit, të një posteri me slogane politike të një aktiviteti elektoral, Komisioneri ka vendosur moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e shqyrtimit administrativ, duke konkluduar se ka ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor<sup>16</sup>. Në vlerësimin e KShH-së, para se të arrihej në këtë përfundim, në këtë çështje duhet të realizoheshin verifikime më të plota dhe të thelluara.

Në kuadër të ndryshimeve që pësoi Kodi Zgjedhor në vitin 2020, një ndër shtesat e bëra ishte mbrojtja e denoncuesve sipas legjislacionit në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të cilët zgjedhin të informojnë drejtpërdrejtë KQZ-në kur kanë dijeni për fakte apo rrethana që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve (neni 123/3 i KZ). Por pavarësisht kësaj mbrojtje, sikurse është evidentuar më lart, numri i sinjalizimeve nga publiku është shumë i ulët. Dy prej

---

<sup>16</sup> Jo të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, sa kohë që gjatë hetimit administrativ ky poster nuk ka rezultuar i publikuar por denoncuesi ka paraqitur prova fotografi për ekzistencën e tij,

vendimmarrjeve të Komisionerit të analizuara në këtë raport janë publikuar të anonimizuara plotësisht<sup>17</sup> dhe pjesërisht<sup>18</sup>, duke pasqyruar standard të ndryshëm të anonimizimit.

Në analizë të veprimtarive objekt denoncimi, KShH ka konstatuar se për natyra të njëjta aktiviteteve të kategorizuara si ‘inspektime/kontrolle’<sup>19</sup>, ndërmjet KAS dhe Komisionerit janë mbajtur qëndrime të ndryshme. Rezulton se në vendimmarrjet e tij KAS i ka respektuar qëndrimet e Kolegjit Zgjedhor, duke i cituar ato në disa raste. Sipas disa përfaqësuesve të KAS, gjatë konsultimit të këtij raporti, u mbajt qëndrimi se standarti i elaboruar në vendimmarrjet e tij duhet të respektohet edhe nga ana e Komisionerit.

---

<sup>17</sup> Vendim nr. 470, datë 09.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 182 ID, 183 ID, 180 ID, 172 ID, 173 ID, 219 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara dhe nr. 226 ID, 227 ID të sinjalizuesit, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, nuk mund të publikohet në respektim nenit 123/3 të Kodit Zgjedhor.

<sup>18</sup> Vendim nr. 685, datë 06.07.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 436 ID, 438 ID, 439 ID me kërkues sinjalizues, 385 ID, 414 ID, 410 ID, 424 ID me kërkues z. Ivi Kaso, 360 ID, 346 ID, 375 ID me kërkues deputetin zj. Albana Vokshi dhe z. Ivi Kaso, 394 ID me kërkues deputetin zj. Albana Vokshi dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, 328 ID, 330 ID, 331 ID me kërkues deputetin z. Flamur Noka për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

<sup>19</sup> Kërkesa ankimore nr. 05 dhe nr. 08, të shqyrtuara nëpërmjet vendimmarrjes së KAS nr. 16, datë 28.02.2023

### 1.1 PROCEDURA E NDJEKUR GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV NGA KQZ

Administrata e KQZ-së në respektim të nenit 123\2<sup>20</sup> të KZ, në përgjithësi është përgjegjëse për realizimin e hetimit administrativ. Përjashtim, ligjvënësi ka parashikuar vetëm në rastet kur kërkohet ekspertizë e posaçme për hetimin e rasteve komplekse. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga KQZ, gjatë hetimeve administrative të ndërmarra për periudhën 10 Mars - 30 Qershor 2023, nuk është kërkuar në asnjë rast ekspertiza e posaçme jashtë administratës.<sup>21</sup>

Në përgjithësi, nga vendimmarrjet objekt studimi, KShH ka konstatuar se hetimi administrativ i KQZ-së ka qenë i plotë dhe në përputhje me standartet e procesit të rregullt ligjor. Kryesisht, administrata e KQZ-së është përfaqësuar në shumicën e seancave publike nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm. Palëve pjesëmarrëse në seancën dëgjimore iu është garantuar e drejta e relatimit të kërkesave dhe argumentave të tyre. Në disa raste, këto palë janë përfaqësuar nga mbrojtësit ligjorë të përzgjedhur prej tyre.<sup>22</sup> Nisur nga kompleksiteti i çështjeve, në jo pak raste, Komisioneri ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ.<sup>23</sup> Në përgjithësi, hetimet administrative të cilat nuk janë mbyllur brenda afatit 60 ditor të përcaktuar në nenin 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021 të Komisionit Rregulator, janë shqyrtuar nga ana e Komisionerit brenda një periudhe 2-3 mujore shtesë.<sup>24</sup>

<sup>20</sup> Neni 123/2 i KZ

<sup>21</sup> Shkresë nr. 6057/1 prot., dt. 30.06.2023 'Kthim përgjigje' lëshuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

<sup>22</sup> Shembull: Mbledhja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dt. 14.03.2023: <https://ëëë.youtube.com/live/g2h1rËtuUYQ?si=2ORhz-umT4zNfYQ2>

<sup>23</sup> Disa prej vendimmarrjeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve: Vendim nr. 674, datë 26.06.2023 "Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 374, 375, 385, 390, 436 dhe 439 ID"; Vendim nr. 673, datë 26.06.2023 "Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 334 ID dhe 348 ID"; Vendim nr. 667 date 21.06.2023 "Për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ për denoncimet nr. 328 ID, 330 ID, 331 ID, 336 ID, 346 ID, 360 ID"; Vendim nr. 416, datë 26.04.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimit të z. Flamur Noka deputet i kuvendit të Shqiperisë ndaj Partisë Socialiste të Shqiperisë për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"; Vendim nr. 182, datë 20.03.2023, "Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike Elbasan ndaj z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"; Vendim nr. 176, datë 17.03.2023 "Për zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike Elbasan ndaj z. Gledian Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

<sup>24</sup> Prsh: Vendim nr. 691, datë 12.07.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 417 ID, 421 ID, 429 ID dhe 431 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", përmbyllur hetimi administrativ nëpërmjet vendim nr. 795, datë 06.10.2023, "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 417 ID të z. Edmond Spaho ndaj z. Gëzim Topçiu kryetar i bashkisë Maliq për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023". Ndërkohë vendimi i mësipërm për zgjatjen e afatit të hetimit administrativ mbi denoncimin nr. 421 ID është përmbyllur në përfundim të hetimit me anë të vendimit nr. 739, datë 28.08.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 421 ID nga Qendra "Qëndresa Qytetare", ndaj zj. Anila Kala, Drejtor i Spitalit Rajonal, Berat, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

Ndërkohë sa i përket zgjatjes së afatit të hetimit administrativ, për periudhën Mars-Qershor 2023, periudhë në të cilën intensiteti i procedurave vërehet i shtuar e dinamik edhe për organet drejtuese të KQZ-së, rezulton se Komisioneri Shtetëror ka vendosur zgjatjen e hetimit administrativ për 10 denoncime. Referuar afateve të shqyrtimit të kërkesave ankimore në KAS, rezulton se është zbatuar afati 10 ditor, sipas pikës 3 të vendimit nr. 3/2020 të Komisionit Rregullator.<sup>25</sup>

Në dy prej rasteve të analizuara, Komisioneri ka vendosur zgjatjen e afatit të denoncimeve me nr. 444 ID dhe nr. 449 ID, të depozituara nga ana e KShH, me objekt ‘thyerjen e heshtjes zgjedhore, referuar pjesëmarrjes së përfaqësuesve politikë në përmbyllje të fushatës zgjedhore në ambientet e Piramidës së Tiranës’ dhe ‘afishimi i materialeve propagandistike në 9 Bashki të vendit’. KQZ argumenton se shtyrja e afatit ka qenë e ndërlidhur me kompleksitetin e këtyre çështjeve, por deri në muajin Maj 2024 në të cilin publikohet ky raport studimor, KQZ nuk ka dhënë përgjigje për procedurat e ndjekura për hetimin administrativ të këtyre denoncimeve dhe rezultatet e tyre.

KShH mirëpret rekomandimin e përfaqësuesve të KAS, për marrjen e masave konkrete nga ana e KQZ-së për krijimin e një strukture të specializuar hetimore, e cila duhet të jetë e pajisur me burimet e duhura dhe të kualifikuara njerëzore si dhe burimet financiare për zhvillimin e hetimeve të gjithëanshme, objektive dhe efektive, në kohë të arsyeshme.

Proaktivitet është vërejtur edhe në mbledhjet publike të realizuara nga KAS, ku përfaqësuesit e administratës së KQZ-së kanë luajtur një rol të rëndësishëm në thellimin e mëtejshëm të hetimit administrativ.

Në jo pak raste, pala ankuese ka treguar një qasje jo bashkëpunuese, duke mos u paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor e duke mos përcjellë prova për mbështetjen e pretendimeve të tyre,<sup>26</sup> duke mos plotësuar dhe korigjuar kërkesën ankimore sipas parashikimeve ligjore në fuqi<sup>27</sup>. Nuk kanë munguar rastet kur pala ankuese nuk ka përcjellë provat shtesë brenda afatit të lënë në dispozicion për plotësim,<sup>28</sup> ose ka hequr dorë nga shqyrtimi i kërkesës ankimore.<sup>29</sup> Rastet e fundit kanë mbingarkuar organet drejtuese dhe administratën zgjedhore të KQZ-së, në kushtet e një procesi të administrimit zgjedhor që paraqet volum dhe dinamikë të lartë.

---

<sup>25</sup> Shkresë nr. 6057/1 prot., dt. 30.06.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

<sup>26</sup> Prsh: Procesverbal i mbledhjes dt. 02.06.2023 i KAS, që përkon me vendimmarrjen nr. 171.

<sup>27</sup> Prsh: Procesverbali i mbledhjes dt. 29.05.2023 i KAS, që përkon me vendimmarrjen nr. 161. Procesverbali i mbledhjes dt. 30.05.2023 i KAS, që përkon me vendimmarrjen nr. 162, dhe nr. 163.

<sup>28</sup> Prsh: Procesverbal i mbledhjes dt. 02.06.2023 i KAS, që përkon me vendimmarrjen nr. 172.


Procesverbal i mbledhjes dt. 30.05.2023 i KAS, që përkon me vendimmarrjen nr. 169.

<sup>29</sup> Vendim nr. 173, datë 02.06.2023 “Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 92, datë 27.05.2023, të depozituar nga ‘Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet’”.


## 1.2 KATEGORITË E “DENONCUESVE” DHE “OBJEKTI I DENONCIMEVE” PRANË KQZ-SË

Në zbatim të nenit 123\1<sup>30</sup> të Kodit Zgjedhor, sa i përket subjekteve që vënë në lëvizje KQZ-në, ligjvënësi ka parashikuar se: “KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së”. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka të drejtë të nisë hetimin kryesisht, sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurës Administrative, për fakte apo të dhëna të bëra publike, të siguruara nga monitoruesit e KQZ ose të marra gjatë kryerjes së funksionit kontrollues administrative të KQZ-së.

KQZ ka informuar KShH-në se gjatë periudhës Janar 2023 deri më 10 Mars 2023, janë depozituar në masë denoncime nga ana e aktorëve të shoqërisë civile, e më konkretisht nga organizatat KRIIK (e cila kryeson ndjeshëm listen me 166 denoncime), ndjekur nga Qëndresa Qytetare me 3 denoncime, subjektet politike me 5 denoncime dhe 2 raste të denoncuar nga sinjalizues që kanë preferuar të mbeten anonim.



<sup>30</sup> Neni 123\1 i KZ KQZ-ja vihet në lëvizje kryesisht, me kërkesë të subjekteve zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme dhe për çështje që bëjnë pjesë në rrethin e kompetencave të KQZ-së, <https://qbz.gov.al/previeë/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>




Nga të dhënat e analizuara, nga vendimmarrjet e publikuara në faqen zyrtare të KQZ-së rezulton se palët e treta, kryesisht organizatat jofitimprurëse, kanë luajtur një rol kyç në sinjalizimin e shkeljeve pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Vlen të theksohet se disa prej vendimmarrjeve të disponuara pas hetimit të denoncimeve të adresuara, kanë shërbyer në krijimin e praktikave pozitive dhe unifikimin e mëtejshëm të trajtimit të rasteve. Ndër rastet pozitive përmenden denoncimet e depozituara nga ana e dy OSHC-ve, Qëndresa Qytetare dhe KShH, si dhe monitoruesi i KQZ-së, mbi shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Bashkisë Korçë për zhvillimin e një veprimtarie të ndaluar në ambientet e Qendrës Sportive Korçë, në të cilën u vërejt përdorim i burimeve publike. Lidhur me këtë aktivitet, më herët KQZ kishte vendosur ndalimin e tij duke e vlerësuar si shkelje administrative, pasi nuk duhet që të ishte raportuar në si një aktivitet institucional nga ana e autoritetit publik. Në këtë rast, i është propozuar KAS marrja e masës administrative me gjobë ndaj Kryetarit të Bashkisë dhe punonjësës përgjegjëse për raportimin, sa i përket organizimit të një eventit të njoftuar si të ndaluar.

Gjatë periudhës Maj - Qershor 2023, organizatat jofitimprurëse renditen të parat në denoncimin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor (200 raste), ndjekur nga subjektet zgjedhore (79 raste). Në numër më të ulët renditen monitoruesit e autorizuar nga KQZ për të monitoruar në terren elementë të caktuar të procesit zgjedhor (8 raste), si dhe sinjalizuesit të cilët nëpërmjet adresimit të denoncimeve të tyre kanë zgjedhur të mbeten anonim (7 raste).


Këto të dhëna të analizuara janë në të njëjtën linjë referimi nga ana e informacionit të vënë në dispozicion nga KQZ, për periudhën Maj-Qershor 2023:





Nga informacioni i vënë në dispozicion nga KQZ<sup>31</sup>, rezulton se gjatë periudhës 10 Maj 2023 deri më 30 qershor 2023 (që përkon me periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore), janë depozituar në total 294 denoncime, për shkelje të parashikuara në dispozitat e neneve 91 dhe 92 KZ dhe të vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Sa i përket objektit të denoncimeve, shumica dërrmuese e tyre është për ‘mosraportim të aktivitetit para datës së raportimit’ (neni 92 KZ), ndjekur nga denoncimet me objekt ‘shpërdorim i burimeve publike dhe burimeve njerëzore’ (neni 91 KZ). Numrin më të ulët të denoncimeve, me vetëm 1 denoncim rezulton për ‘keqinformim nga ana e subjekteve mediatike’ (nenet 84 dhe 85 KZ).

<sup>31</sup> Shkresë nr. 6057/1 prot., dt 30.06.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve



### 1.2.1 KËRKESË\ANKESAT E DEPOZITUARA NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE

Nga të dhënat e analizuara, përgjatë periudhës kohore mars – qershor 2023, më së shumti, denoncimet e depozituara nga subjektet zgjedhore përkojnë me pretendime për cënim të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor<sup>32</sup> që lidhen kryesisht me ndalimin e përdorimit të burimeve publike dhe veprimtarive të institucioneve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore, të cilat nuk respektojnë kushtet e raportimit ose shpërdorojnë burimet publike. Në një masë më të reduktuar janë përcjellë ankesa lidhur me teknologjinë, që nënkupton përdorim të hashtags të faqeve zyrtare të kandidatëve ose kryetarëve të subjekteve zgjedhore nga ana e institucioneve/agjensive të varësisë, ose postime me përmbajtje elektorale kryesisht me pjesëmarrjen e drejtuesve politikë të qarqeve në inagurime ose takime të ndryshme me pjesëmarrje të përfaqësuesve të autoriteteve publike. Afishimi i materialeve propagandistike është pretenduar nga ana e ankuesve se është realizuar në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, e më konkretisht në fasadat e godinave duke

<sup>32</sup> Neni 91 dhe 92 I KZ <https://qbz.gov.al/previeë/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

mos pasqyruar shënimin përkatës për përgjegjësinë ligjore<sup>3334</sup>, ose në një distancë të vogël në raport me zyrën kryesore elektorale<sup>35</sup>. Njëkohësisht, aktorë të shoqërisë civile si KRIIK i kanë kërkuar Komisionerit heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike të vendosura në kundërshtim me ligjin në aksin rrugor kombëtar nga Tirana në drejtim të Lushnjës. Në përfundim të hetimit administrativ të Komisionerit, u kërkua mobilizimi i Policisë së Shtetit dhe asaj bashkiake nën kompetencën e katër bashkive të vendit për të hequr në mënyrë të menjëhershme materialet propagandistike.<sup>36</sup>

Në fakt, gjatë periudhës objekt monitorimi, është konstatuar jo vetëm pakujdesi nga ana e subjekteve zgjedhore për respektuar ligjin sa i përket afishimit të materialeve propagandistike, por edhe mosmarrje e masave konkrete nga ana e 13 Bashkive për të dorëzuar në KQZ vendimet e tyre për përcaktimin e vendeve publike që do të shërbejnë për afishimin sipas nenit 79 KZ.<sup>37</sup> Për këtë arsye, me propozim të Komisionerit, KAS ka vendosur sanksione administrative ndaj kryetarëve të Bashkive. Në vlerësimin e KShH-së, diskutimet e shkëmbyera nga anëtarët e KAS në mbledhjen e datës 15 Maj 2023, kundrejt administratës së KQZ-së, sa i përket masave të kërkuara për t'u vendosur ndaj Policisë Bashkiake, kanë elementë diktues<sup>38</sup>. Pushimi i vendimmarrjes administrative, i cili në këtë rast erdhi si një kërkesë fillimisht “e udhëzuar” ndaj sekretarit të përgjithshëm të KQZ-së, në respektim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, duhet të ishte një qëndrim i pavarur i vetë këtij funksionari të nivelit më të lartë të administratës publike të KQZ-së.

---

## 1.2.2 KËRKESË\ANKESAT E DEPOZITUARA NGA PALËT E TRETË

Që në krye të herës, evidentuam se OSHC-të në cilësinë e denoncuesit palë e tretë kanë luajtur një pro-aktiv në përcjelljen e denoncimeve drejt KQZ, duke u renditur të parët me numrin më të lartë të ankesave apo denoncimeve.

---

<sup>33</sup> Vendim nr. 495, datë 11.5.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 406 nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për afishimin e materialeve propagandistike të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” në Bashkinë Himarë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

<sup>34</sup> Vendim nr. 453, datë 6.5.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 369, nga z. Ivi Kaso për afishimin e materialeve propagandistike, në vendet e reklamave ndriçuese, në ambientet publike të Bashkisë Kukës, nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

<sup>35</sup> Vendim nr. 493, datë 11.5.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 397, nga z. Ivi Kaso për afishim të materialit propagandistik të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në bashkinë Dibër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

<sup>36</sup> Vendim nr. 455, datë 6.5.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 386 nga KRIIK për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në aksin rrugor kombëtar Tiranë Lushnjë”.

<sup>37</sup> Vendim nr. 466, datë 08.05.2023 “Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa kryetarëve të bashkive për mosdorëzimin e vendimit për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkive përkatëse për afishimin prej subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike”.

<sup>38</sup> Procesverbal i mbledhjes së dt. 15.05.2023, të KAS: [https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/230515\\_KAS-seancat-e-dt.15.05.2023.pdf](https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/230515_KAS-seancat-e-dt.15.05.2023.pdf)

OSHC-të rezulton se janë angazhuar aktivisht edhe në dhënien e rekomandimeve/sugjerimeve për përmirësimin e draft-akteve të ndryshme, si dhe kundërshtimin e vendimmarrjeve të vetë Komisionerit Shtetëror pranë KAS.

Megjithatë, jo në të gjitha rastet denoncimet e OSHC-ve janë shoqëruar me hetime administrative të plota dhe të gjithëanshme, për të konkluduar në mënyrë të drejtë dhe objektive nëse ka patur shkelje apo jo.

Edhe pse rasti që trajtohet në këtë paragraf nuk i përket kampionit të vendimmarrjeve brenda periudhës objekt monitorimi, ka tërhequr vëmendjen e KShH-së, mënyra e shqyrtimit të tij nga ana e Komisionerit Shtetëror. Nëpërmjet denoncimit të organizatës Qëndresa Qytetare është kërkuar marrja e masave për ndalimin e aktivitetit të kandidatit për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës. Në vijim të kontestimeve nga subjekti zgjedhor (kandidati), monitoruesit e organizatës në terren vendosën në dispozicion të dhëna se si në mediat sociale, posterit propagandues për organizimin e këtij eventit është fshirë vetëm disa orë para organizimit të seancës dëgjimore pranë KQZ-së ndërkohë që dhe vetë eventit është organizuar. Nga studimi i vendimit, të dhënat e paraqitura si nga ana e monitoruesit të KQZ-së, ashtu edhe ato të grumbulluara në kuadër të hetimit administrativ mbi objektin e denoncimit, nuk krijohet bindje e arsyeshme, nëse aktiviteti përmbyllës i organizuar nga kandidati përbën një veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, dhe nëse pjesëmarrësit në të identifikohen si përfaqësues të administratës zgjedhore në kuptim të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Në rastin e kërkesës ankimore të depozituar nga organizata Qëndresa Qytetare ndaj kësaj vendimmarrje, KAS vendosi mospranimin për shqyrtim të saj, për shkak të depozitimit përtej afatit të së drejtës për ushtrimin e ankimit i parashikuar nga neni 130, pika c) KZ.<sup>39</sup>

---

### 1.2.3 HETIMI ADMINISTRATIV KRYESISHT (*EX OFFICIO*) NGA ANA E KQZ

Bazuar në nenin 123, paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka të drejtë të nisë hetimin kryesisht (*ex officio*), sipas procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative, për fakte apo të dhëna të bëra publikisht të siguruara nga monitoruesit e KQZ ose të marra gjatë kryerjes së funksionit kontrollues administrativ të KQZ-së.

Për periudhën 10 Mars – 30 Qershor 2023, evidentohet se Komisioneri Shtetëror ka kryer hetim *ex officio vetëm* në 8 raste, si rrjedhojë e të dhënave të ëprcjella nga monitoruesit e kontraktuar nga KQZ. Sikurse evidentojnë statistikisht këto të dhëna, numri i hetimeve me nismën e vetë KQZ-së dhe po ashtu numri i sinjalizimeve nga qytetarët që analizohet në nënseksionin në vijim paraqitet tepër i ulët.

---

<sup>39</sup> Vendim nr. 194, datë 18.12.2023 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 96, datë 04.12.2023 të depozituar nga Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare”.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 92 pika 1 të KZ dhe vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, KQZ ka zhvilluar çdo javë monitorime *ex officio* lidhur me raportimin me vonesë të veprimtarive me karakter publik, nga institucionet publike. Për periudhën Janar-Mars 2023, Komisioneri raporton se ka dhënë 6 vendime për ‘pushimin e procedimit administrativ për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve publike’. Ndërkohë që në 6 vendime të tjera, Komisioneri i ka propozuar KAS masë administrative me gjobë në vlera që variojnë nga 10.000-20.000 lekë. Pas shqyrtimit të kërkesave të mësipërme KAS ka vendosur nëpërmjet 4 vendimmarrjeve të tij, në 3 raste të pranojë kërkesën e Komisionerit dhe të vendosë sanksionin e propozuar administrativ, ndërkohë që në 1 rast është vendosur pranimiti i pjeshëm i kërkesës së Komisionerit dhe vendosjen e masës administrative në vlerën 50% më të reduktuar, konkretisht 10.000 lekë.<sup>40</sup>

Pas informacionit të grumbulluar rezultoi se 13 Bashki të vendit nuk kishin respektuar njoftimin shkresor të përcjellë nga Komisioneri për përcaktimin e vendeve publike në territorin në juridiksion të tyre, për afishimin e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të subjekteve zgjedhore, çështje e cila është trajtuar edhe më sipër.<sup>41</sup>

Gjithashtu, në disa raste, Komisioneri ka vendosur ndalimin e zhvillimit të aktiviteteve me karakter publik të planifikuara për t’u realizuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore<sup>42</sup>, Ujësjellës Kanalizime<sup>43</sup> dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<sup>44</sup> ose ajo e Kulturës<sup>45</sup>, për shkak së këto evente janë raportuar në mosrespektim të afatit 5 ditor përpara zhvillimit të planifikuar, ose në cilësinë e pjesëmarrësve në kuadër të fushatës zgjedhore janë raportuar përfaqësues partiakë.

KShH e vlerëson pozitivisht monitorimin proaktiv që administrata e KQZ-së i ka realizuar ndërfaqes së raportimeve të veprimtarive publike nga ana e autoriteteve përgjegjëse, ndërkohë

---

<sup>40</sup> Shkresë nr. 1618/1 prot., dt. 23.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

<sup>41</sup> Vendim nr. 466, datë 08.05.2023 “Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa kryetarëve të bashkive për mosdorëzimin e vendimit për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkive përkatëse për afishimin prej subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike”.

<sup>42</sup> Vendim nr. 413, datë 25.04.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Maliq”. Vendim nr. 367 datë 15.4.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Tiranë”. Vendim nr. 356, datë 14.04.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter public të bashkisë Belsh”. Vendim nr. 231, datë 31.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Korçë”. Vendim nr. 212, datë 28.03.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Bashkisë Lushnjë”. Vendim nr. 204, datë 24.03.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik, të raportuar nga Bashkia Memaliaj”. Vendim nr. 190, datë 21.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Gjirokastrë”. Vendim nr. 184 datë 20.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Bashkisë Kavajë”.

<sup>43</sup> Vendim nr. 213 datë 28.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Cërrik, Ujësjellës Kanalizime Cërrik”.

<sup>44</sup> Vendim nr. 197, datë 23.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

<sup>45</sup> Vendim nr. 191, datë 21.3.2023 “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Ministrisë së Kulturës”.


që qëndrimi i mbajtur nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ndalimin e këtyre veprimtarive i ka shërbyer vetëm pjesërisht shpërdorimit të burimeve publike.

#### 1.2.4 KËRKESAT/ANKESAT NGA SINJALIZUESIT

Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave, që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative në fushën e zgjedhjeve, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt KQZ-në, në zbatim të nenit 123 pika 3 të KZ. Në referim të legjislacionit të posaçëm nr. 60\2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, të drejtat e interesat e denoncuesit janë të mbrojtura në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga KQZ, në periudhën Janar – 10 Mars 2023, KQZ ka bërë me dije se 2 raste janë përcjellë nga sinjalizues.<sup>46</sup> Ndërkohë, referuar po këtyre të dhënave, për periudhën 10 Maj – 30 Qershor 2023, evidentohen 7 sinjalizime të adresuara nga qytetarët, të cilat kanë si objekt pretendime ‘për shpërdorim të burimeve publike’, ndjekur në minorancë nga denoncimet me objekt ‘mosraportim të veprimtarisë publike institucionale’ ose ‘hapje zyre zgjedhore në kundërshtim me udhëzimin nr. 6/2021 të Komisionerit’. Të gjitha këto raste kanë zgjedhur të mbeten anonime.

Këto të dhëna të pasqyruara, pavarësisht se të pakëta në numër në aspektin statistikor, reflektojnë një këndvështrim premtues sa i përket proaktivitetit që qytetarët janë përpjekur të luajnë nëpërmjet monitorimit të fushatës zgjedhore, e më së shumti impaktin që ajo ka tekë përfaqësuesit e administratës publike apo dhe të vetë fondeve publike.



<sup>46</sup> Shkresë nr. 1618/1 prot., dt. 23.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Në tërësi nuk është vërejtur një pjesëmarrje e lartë e publikut në denoncimin e shkeljeve. Disa prej denoncimeve të adresuara nga ana e sinjalizuesve janë pasqyruar në mbrojtje të plotë të së drejtës së konfidencialitetit, ndërkohë që Komisioneri është kujdesur për anonimizimin e pjesshëm<sup>47</sup> ose atë të plotë<sup>48</sup> të vendimmarrjes. Në të dyja këto vendimmarrje objekt shqyrtimi konstatohet se krahas denoncimit të sinjalizuesit, janë bashkuar në të njëjtin procedim administrativ edhe denoncimet e organizatave joqeveritare ose deputetëve të Kuvendit të RSH-së. Në kushtet e mospasjes së një informacioni të saktë mbi objektin e këtyre denoncimeve, mbetet e paqartë arsyeja e anonimizimit të disa të dhënave që nuk i përkasin sinjalizuesve. Në vlerësimin e KShH-së, qëllimi i legjislacionit për sinjalizuesit është të garantojë mbrojtjen nga hakmarrja dhe masave të tjera cënuese që mund të ndërmerren vetëm ndaj sinjalizuesit. Në kushte kur pjesë e procedimit administrativ bashkë me të dhënat e sinjalizuesve kanë qenë edhe organizata joqeveritare, jo të pozicionuara në cilësinë e një sinjalizuesi, kërkesat dhe argumentet e tyre duhet të ishin publikuar për t'i shërbyer transparencës kundrejt publikut.

### 1.3 PALËT E TRETA TË INTERESUARA NË CILËSINË E DENONCUESIT

Gjatë hetimit administrativ të ndërmarrë, KQZ ka bazuar vendimmarrjen e saj në të dhëna të faktuara që janë venosur nga pallet e treta denoncuese, kryesisht OSHC, si KRIIK<sup>49</sup> dhe Qëndresa Qytetare<sup>50</sup>. Kontributi i OSHC-ve përgjatë këtij procesi tregon rolin proaktiv që ato kanë patur në parandalimin dhe ndëshkimin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor.

---

<sup>47</sup> Vendim nr. 685, datë 06.07.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 436 ID, 438 ID, 439 ID me kërkues sinjalizues, 385 ID, 414 ID, 410 ID, 424 ID me kërkues z. Ivi Kaso, 360 ID, 346 ID, 375 ID me kërkues deputetin zj. Albana Vokshi dhe z. Ivi Kaso, 394 ID me kërkues deputetin zj. Albana Vokshi dhe Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, 328 ID, 330 ID, 331 ID me kërkues deputetin z. Flamur Noka për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

<sup>48</sup> Vendim nr. 470, datë 09.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 182 ID, 183 ID, 180 ID, 172 ID, 173 ID, 219 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara dhe nr. 226 ID, 227 ID të sinjalizuesit, për shkelje administrative, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, nuk mund të publikohet në respektim nenit 123/3 të Kodit Zgjedhor.

<sup>49</sup> Vendimi 115 datë:18.05.2023, <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-115-date-18.05.2023-Kerkesa-nr.-31-KSHZ.pdf>;

Vendimi 114 datë:15.05.2023, <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-114-date-15.05.2023-Shqyrtimi-i-kerkeses-nr.-30-Lako.pdf>;

Vendimi 87 datë:10.05.2023, <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-87-date-10.05.2023-Shqyrtim-23-KSHZ.pdf>,

Vendimi 84 datë:08.05.2023

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/vendim-nr.-84-date-08.05.2023-Shqyrtim-K.-21-e-KSHZ-V.441.pdf>

Vendimi 86 datë:10.05.2023, <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-86-date-10.05.2023-Shqyrtim-22-KSHZ.pdf>

<sup>50</sup> Vendimi 85 datë:08.05.2023, <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-85-date-08.05.2023-Shqyrtim-19-20-KSHZ.pdf>

Në disa raste, pavarësisht ankuesve apo “denoncuesve” të ndryshëm, objekti i kërkesë/ankesave ka qenë i mbështetur në të njëjtat fakte, e si rrjedhojë Komisioneri ka vendosur shqyrtimin bashkërisht të tyre, duke disponuar nëpërmjet një vendimmarrjeje.

Në një nga këto raste, Komisioneri ka shqyrtuar bashkërisht denoncimet e përcjella nga organizata Qëndresa Qytetare dhe KShH, të cilat kishin në objekt marrjen e masave për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar nga Bashkia Korçë. Komisioneri i ka propozuar KAS marrjen e masave për ndëshkimin administrativ të Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe personit përgjegjës për raportimin për organizimin e një eventit të njoftuar si të ndaluar nga KQZ.<sup>51</sup> Ndërkohë në një rast tjetër, denoncimi i KShH është bashkuar me atë të përcjellë nga një deputete e Kuvendit të RSH-së. KShH referonte të dhëna se po cenoheshin dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimmarrjeve të Komisionit Rregullator, si rrjedhojë e faktit se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Korçë, ka adresuar kërkesa të përsëritura drejt stafëve pedagogjike, duke kërkuar informacion mbi numrin e ndjekësve të faqes, numrin e postimeve për veprimtaritë shkollore dhe numrin e ri-postimeve të kryera në llogaritë e rrjeteve sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Referuar hetimit administrativ të ndërmarrë nga Komisioneri, u vendos ndalimi i postimeve apo ripostimeve në rrjetet sociale të një institucioni publik, të aktiviteteve të cilat pasyqrohen në profilin personal të drejtuesit të institucionit publik, përse kohë që këto profile i konsiderojnë profile të tyre personale.<sup>52</sup>

Pavarësisht këtij vendimi të rëndësishëm “precedent”, KShH me shqetësim ka vërejtur se autoritetet publike kanë përsëritur sjellje të njëjta apo të ngjashme. Vendimmarrja e KQZ-së si rrjedhojë nuk i shërbeu parandalimit të këtyre shkeljeve. Si rrjedhojë, KShH vlerëson se është e nevojshme të fuqizohen kapacitetet e KQZ-së dhe monitoruesve të saj, për të kqyrrur efektivisht hapësirën teknologjike në rrjetet sociale të subjekteve zgjedhore, kandidatëve përgjegjës dhe aktorëve institucionalë.

Gjithashtu, KShH i adresoi Komisionerit denoncimin për shpërdorimin e burimeve njerëzore të institucioneve në varësi të Bashkisë Vlorë, për qëllime zgjedhore. Nga hetimi administrativ i realizuar nga Komisioneri, u argumentua se dy kushtet thelbësore të parashikuara në nenin 91 pika 2 të KZ “përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore” nuk arriten që të vërtetohen për shkak të mosprezencës së kandidatëve për kryetar bashkie apo këshillit bashkiak.<sup>53</sup> Ky vendim është marrë edhe pse

---

<sup>51</sup> Vendim nr. 412, datë 25.04.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 246 ID, 284 ID, 285 ID, të monitoruesit, Qendrës “Qëndresa Qytetare” dhe organizatës “Komiteti Shqiptarë i Helsinkit” ndaj kryetarit të bashkisë Korçë dhe personit përgjegjës për bashkinë Korçë, për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe përdorimin e burimeve publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

<sup>52</sup> Vendim nr. 421, datë 03.05.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 222 ID, të organizatës “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” dhe denoncimit nr. 228 të deputetit zj. Albana Vokshi ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

<sup>53</sup> Vendim nr. 432, datë 03.05.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 338 ID nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, për zj. Anita Shehu, inspektor borxhi në bashkinë Vlorë, zj. Kozeta Halili specialiste turizmi, Drejtoria



ka rezultuar e provuar nga hetimi administrativ se aktiviteti është realizuar gjatë orarit zyrtar të punës, një një datë e cila nuk është klasifikuar si pushim zyrtar. Fakti i logimit të ftesës së aktivitetit nën logon e një partie politike, e cila pavarësisht se në datën përkatëse nuk është regjistruar ende si subjekt zgjedhor, por nga ana tjetër përfaqëson një ndër forcat më të mëdha politike që ka mazhorancën qeverisëse, e bën dukshëm këtë aktivitet si pararendës të fushatës ligjore zgjedhore, në shpërdorim të burimeve publike.

Rezultate pozitive u shënuan nga denoncimet e Qëndresës Qytetare ndaj funksionarëve të lartë e të mesëm drejtues si Kryetari i Bashkisë Kukës, Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, Drejtorëve të dy prej shkollave 9-vjeçare në Kukës.<sup>54</sup> Në të dy këto denoncime të hetuara administrativisht nga KQZ, u konstatua se veprimtaritë e organizuara kanë qenë në çenim të nenit 92 KZ. Përdorimi i ambienteve publike, përkatësisht oborreve të shkollave respektive cenoni nën 91 pika 1 të KZ. KAS vendosi masë administrative gjobë 10-fish më të lartë ndaj kryetarit të Bashkisë, në raport me masën e kërkuar nga Komisioneri,<sup>55</sup> ndërkohë që ngarkoi me përgjegjësi administrative edhe kreun e ASHK-së duke e gjobitur me një masë administrative të reduktuar dhe jo proporcionale në vlerën 2,500 Lekë.<sup>56</sup>

Vendimmarrja e KAS, si rrjedhojë e ankimit të përcjellë nga Qëndresa Qytetare, për ndryshimin e vendimit të Komisionerit dhe dënimin me gjobë të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është shoqëruar me një mendim pakice. Ndërmjet Komisionerit dhe KAS, vërehet qëndrim i njëjtë i takon konceptit të veprimtarisë së ndaluar që sipas tyre nuk vërehet në rastin konkret (vizita në ambientet e spitalit rajonal Lezhë nga kandidati për kryetar Bashkie, drejtuesi politik i qarkut dhe Ministria përgjegjëse), sa kohë që aktiviteti nuk është organizuar pas fillimit të fushatës zgjedhore.<sup>57</sup>

Nga analiza e mendimit të dy anëtarëve në pakicë, rezulton objektivisht e argumentuar se *“Veprimtaria ka pasur qëllim promovues jo vetëm të një investimi të kryer, por edhe të politikave qeveritare në fushën e shëndetësisë, specifikisht për shëndetësinë në Qarkun Lezhë.*

---

e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkinë Vlorë, subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

<sup>54</sup> Vendim nr. 440, datë 05.05.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 336 ID të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj kryetarit të bashkisë Kukës, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati” Kukës dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023”.

Vendim nr. 439, datë 05.05.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 335 ID të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj kryetarit të bashkisë Kukës, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi” Kukës dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023”.

<sup>55</sup> Vendim nr. 100, datë 11.05.2023 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 58, datë 11.05.2023 të depozituar nga kryetari i bashkisë Kukës z. Safet Gjici”.

Vendim nr. 96, datë 11.05.2023 “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 59, datë 11.05.2023 të depozituar nga kryetari i bashkisë Kukës z. Safet Gjici”.

<sup>56</sup> Vendim nr. 85, datë 08.05.2023 “Për shqyrtimin e kërkesave nr.19 dhe nr. 20, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

<sup>57</sup> Vendim nr. 45, datë 04.04.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 38, datë 27.03.2023 të depozituar nga Qendra ‘Qëndresa Qytetare’”.

*Ajo është zhvilluar në kuadër të veprimtarive politiko-elektorale të Partisë Socialiste, gjegjësisht në dobi të saj. Ndryshe nuk ka shpjegim, as justifikim, pjesëmarrja në veprimtari e drejtuesit politik të Qarkut Lezhë.* “ KShH vlerëson se neni 91 pika 1 KZ duhet argumentuar në favor të karakterit detyrues që e karakterizon, pra ndalimin e përdorimit të burimeve publike gjatë gjithë periudhës 4 muaj para datës së zgjedhjeve.

KRIIK një tjetër aktor proaktiv i SHC ka adresuar disa denoncime pranë Komisionerit Shtetëror. Objekti i këtyre denoncimeve ndërlidhet së pari, me kërkesën për heqje të materialeve propagandistike të afishuara në disa akse rrugore. Edhe pse qartësisht këto materiale aksesoheshin nga përdorues (drejtues të mjeteve) të rrugëve publike, në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se standat e afishimit konsiderohen prona private e leje të posaçme janë marrë nga subjektet private.<sup>58</sup> Së dyti, denoncimet e KRIIK janë për organizimin e veprimtarive publike nga institucionet publike në mungesë të raportimit në ndërfaqen e krijuar për këtë qëllim, të cilat u gjetën bazuara nga KQZ, pjesërisht vetëm ndaj disa institucioneve.<sup>59</sup> Së tregi, denoncime janë depozituar me objekt postimin me përmbajtje elektorale nga institucione të ndryshme publike si dhe kryetar apo kandidatë për kryetar bashkie, që kanë postuar apo ripostuar në faqet e tyre personale publikime me përmbajtje partiake, apo autoritet e agjenci publike që kanë bërë publikime me qëllim promovimin e sloganeve politike<sup>60</sup>. Konkretisht, në rastin e publikimit në rrjete sociale të Agjencisë së Medias dhe Informimit (MIA) institucion në varësi të drejtpërdrejtë të kryeministrit, të një posterit me slogane politike të një aktiviteti elektorale, jo të raportuar në ndërfaqen e KQZ-së, Komisioneri ka vendosur moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e shqyrtimit administrativ pasi postimi ka ndodhur për shkak të një gabimi njerëzor.<sup>61</sup> Në vlerësimin e KShH-së, pavarësisht nga fakti se gjatë hetimit administrativ ky poster nuk ka rezultuar i publikuar, nisur nga fakti se denoncuesi ka paraqitur prova fotografi për ekzistencën e tij, KQZ mund të kishte kërkuar ndihmën e një eksperti të fushës për të bërë verifikime më të plota hetimore dhe për të arritur në konkluzione me objektive.

Gjithashtu, pas sinjalizimeve të adresuara nga KShH për keqinformimin dhe presionin e ushtruar ndaj disa qytetarëve të Bashkisë Elbasan për leximin e votës nga të tretët, të ushtruar me sistemin e pilotimit të votimit dhe numërimit elektronik, Komisioneri informoi publikun

---

<sup>58</sup> Vendim nr. 483, datë 10.5.2023 “Mbi denoncimin nr. 326 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

<sup>59</sup> Vendim nr. 410, datë 25.04.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 243 ID dhe nr. 250 ID, të monitoruesit dhe nr. 258 ID, nr. 259 ID, nr. 260 ID, nr. 264 ID, nr. 265 ID, nr. 266 ID, nr. 267 ID, nr. 269 ID, nr. 270 ID, të koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj personave përgjegjës, për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023’.

<sup>60</sup> Vendim nr. 490, datë 11.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 368 ID, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Ministrave dhe personave përgjegjës në disa ministri, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

<sup>61</sup> Vendim nr. 489, datë 11.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 365 ID, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë për Media dhe Informim, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

nëpërmjet një deklaratë zyrtare<sup>62</sup>. Deklarata e lëshuar nga Komisioneri kishte si qëllimin ‘qetësimin’ e elektoratit sa i përket sigurisë dhe garantimit të të dhënave që ofrohen nga ana e pajisjeve elektronike të përdorura për këtë qëllim.

#### 1.4 BASHKËPUNIMI NDËRMJET KQZ DHE ORGANEVE PUBLIKE

Mbarëvajtja e hetimit administrativ është e lidhur edhe me bashkëpunimin e organeve publike kundrejt KQZ-së, çka i shërben pozitivisht një hetimi cilësor, të plotë dhe të gjithëanshëm.

Gjatë procesit të shqyrtimit kur subjekti denoncues pretendon shkelje nga institucionet publike organet e KQZ-së ftojnë këto të fundit të marrin pjesë në proces dhe KQZ-ja u kërkon organeve të administratës publike të vënë në dispozicion informacione, dokumente ose çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ. Organet e administratës publike janë të detyruara të vënë në dispozicion provat, sipas Kodit Zgjedhor, me marrjen e kërkesës së KQZ-së dhe brenda afatit të përcaktuara në të.

Rastet kur KQZ ka kërkuar disponimin e provave nga këto organe, në disa raste ka marrë përgjigje, por në raste të tjera institucionet publike nuk kanë marrë pjesë në proces dhe nuk janë treguar bashkëpunuese me KQZ-në për konstatimin dhe vënien në dispozicion të provave të kërkuara nga kjo e fundit.

Konkretisht, pas shqyrtimit të denoncimit të depozituar nga ana e deputetes së Kuvendit të RSH-së, nëpërmjet të cilit pretendohet se shkolla 9-vjeçare “Todi Koçeli” ka publikuar një veprimtari publike, në faqen zyrtare në “Facebook” që përkon me statuset e kandidatëve në garën për zgjedhjet vendore të 14 majit, Komisioneri kërkoi informacion spjegues nga ana e palëve në proces. Kjo kërkesë nuk mori përgjigje, ndërkohë që as palët përgjegjëse nuk u paraqitën në seancën dëgjimore publike. Komisioneri i propozoi KAS marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 4,000 lekë ndaj drejtorit të shkollës.<sup>63</sup>

Megjithatë, ka patur raste të tjera kur është vërejtur bashkëpunim pozitiv i organeve publike me KQZ-së, sikurse kanë qenë institucione si Ministria Brendshme dhe Bashkia Berat<sup>64</sup>,

---

<sup>62</sup> [Testohet pajisja për votim elektronik, Celibashi: Garanton 100% fshehtësinë e votës! Në Elbasan, Vorë e Kamëz rezultati del brenda 30 minutave - Shqiptarja.com](#)

<sup>63</sup> Vendim nr. 436, datë 03.05.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 283 ID, të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zj. Albana Vokshi, ndaj Drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Todi Koçeli”, Selenicë, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

<sup>64</sup> Vendimi 409 datë:25.04.2023,

[https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim\\_nr.-409-date-25.04.2023\\_Per-pushim-procedimi-administrativ-bashkia-BERAT.pdf](https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim_nr.-409-date-25.04.2023_Per-pushim-procedimi-administrativ-bashkia-BERAT.pdf)

Bashkia e Korçës,<sup>65</sup> Bashkia Patos, Dibër dhe Roskovec,<sup>66</sup> të cilat kanë dhënë informacion lidhur me denoncimet e adresuara ndaj tyre me objekt shpërdorimin e burimeve publike dhe për zhvillimin e aktiviteteve me përmbajtje elektorale në çanim të dispozitave ligjore në fuqi.

### **1.5 NIVELI I RESPEKTIMIT TË SË DREJTËS PËR PROCES TË RREGULLT LIGJOR GJATË SEANCËS DËGJIMORE PUBLIKE**

Në rastet kur denoncuesi\palë e tretë kërkon të drejtën për t'u dëgjuar pranë KQZ-së në një seancë dëgjimore, në respektim të nenit 88 të Kodit të Procedurës Administrative, KQZ është e detyruar që të garantojë respektimin e kësaj të drejte duke përcaktuar afatin përkatës. Në rast se pavarësisht caktimit të afatit për realizimin e seancës dëgjimore, denoncuesi\palë e tretë nuk merr pjesë në seancë, kjo nuk përbën shkak që KQZ të shtyjë procesin e vendimmarrjes së saj.

Seancat dëgjimore publike të realizuara nga KQZ janë përcjellë në kohë reale edhe nëpërmjet transmetimit live të mbledhjeve në kanalën e dedikuar në Youtube. Nga monitorimi online i vëzhguesve të KShH-së, në raste tepër sporadike, janë konstatuar raste të pamundësisë për të dëgjuar online diskutimin e shkëmbyer ndërmjet administratës së KQZ-së apo palëve të tjera ndërgjyqëse<sup>67</sup>.

Në përgjithësi, përfaqësuesit e OSHC-ve, denoncimet e të cilëve janë analizuar në këtë raport kanë ndjekur seancat dëgjimore të mbledhjeve të realizuara me objekt shqyrtimin e kërkesave ankimore të tyre. Një tjetër qasje është reflektuar nga ana e subjekteve zgjedhore, gjatë shqyrtimit të çështjeve me objekt cenimin e interesave ligjore të tyre pranë KAS. Përfaqësuesit ligjorë të këtyre subjekteve marrin pjesë në seancë dëgjimore, vetëm në rastet kur ankohen pranë KAS, kundër vendimeve të Komisionerit. Në rastet kur kundrejt këtyre subjekteve politike adresohen shkelje nga Komisioneri, i cili i drejtohet KAS me kërkesën për vënien e sanksionit, në shumicën e rasteve ata nuk kanë marrë pjesë në proces.

Nga ana e KQZ-së është garantuar e drejta e palëve për t'u dëgjuar dhe mbrojtur me përfaqësuesit e tyre, në procesin e shqyrtimit administrativ.

Mosdijenja e palëve për procedurën administrative ka sjellë tërheqjen e kërkesës ankimore nga procedura e shqyrtimit prej Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së. Në këtë rast, KAS ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 28, datë 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për faktin se 57 drejtuesit e Policive Bashkiake ndaj të cilëve

---

<sup>65</sup> Vendimi 412 datë:25.04.2023,

[https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-412-date-25.04.2023\\_Per-sanksion-bashkia-Korce.pdf](https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-412-date-25.04.2023_Per-sanksion-bashkia-Korce.pdf)

<sup>66</sup> Vendimi 396 datë:22.04.2023

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/04/Vendim-396-date-22.04.2023Per-pushim-procedimi-administrativ-burime-publike.pdf>

<sup>67</sup> Shkëputje e audios në mbledhjen e mbajtur më dt. 01.03.2023, nga KAS.

Komisioneri kërkonte vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë prej KAS, nuk kishin marrë dijeni për procedurën hetimore administrative të ndërmarrë nga Komisioneri.<sup>68</sup>

## **1.6 NDËRVEPRIMI I KQZ-SË GJATË PROCEDIMIT ADMINISTRATIV NË FUNKSION TË PROCESIT TË TË PROVUARIT**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në cilësinë e një organi monokratik, i drejton vetë seancat dëgjimore publike. Ndërkohë, KAS është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë. Në disa prej seancave publike të monitoruara, KAS ka operuar me 4 anëtarë<sup>69</sup>, duke disponuar me vendimmarrje në respektim të Rregullores ‘Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve’.

Ndërveprimi dhe diskutimet gjatë mbledhjeve dhe seancave dëgjimore ndërmjet anëtarëve të KAS dhe atyre e administratës së KQZ-së, si dhe me palët pjesëmarrëse në proces kanë qenë proaktiv. Rezulton se janë bërë pyetje që i kanë shërbyer plotësisht të mëtejshëm të hetimit administrativ, duke grumbulluar të dhëna dhe informacion. Gjithashtu, anëtarët e KAS kanë adresuar në përgjithësi kërkesa ndaj administratës së KQZ-së, me qëllim sigurimin e provave e materialeve të nevojshme për procesin. Vetë KQZ ka mbajtur qëndrimin se, ndërveprimi dhe informimi i palëve të interesuara në raport me njohjen e kuadrit ligjor dhe procedurave që ndiqen në shqyrtimin e ankimeve/denoncimeve të kryera, ka rezultuar i suksesshëm si pasojë edhe e precedentëve të krijuar dhe ndërgjegjësimit të palëve.<sup>70</sup>

Megjithatë, bazuar në të dhënat nga monitorimi i seancave dëgjimore publike të mbajtura dhe analiza e procesverbaleve dhe vendimeve të zbardhura e të arsyetuara, KShH vëren se në shumicën e rasteve, provat janë siguruar nga subjekti denoncues. Nuk kanë munguar kërkesat e denoncuesve ndaj KAS, për marrjen e provave nga ana e vetë administratës së KQZ-së, për shkak të disponimit të protokollit apo të materialeve zgjedhore prej tyre. Siç më herët është analizuar, jo në të gjitha rastet, organet publike kanë treguar një qasje bashkëpunuese për të vënë në dispozicion të KQZ-së provën e kërkuar.

## **1.7 HEQJA DORË NGA ANKIMI**

Neni 142 i Kodit Zgjedhor i njej të drejtën ankuesit për të hequr dorë dorë tërësisht apo pjesërisht nga objekti i ankimit në çdo fazë të shqyrtimit të tij. Në këtë rast, KQZ-ja vendos pushimin e çështjes në tërësi ose për pjesën që është hequr dorë. Pas kësaj ankuesi nuk mund të paraqesë përsëri ankim, për çështje të cilat janë pushuar.

---

<sup>68</sup> Vendim nr. 112, datë 15.05.2023 “Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës nr. 28, datë 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

<sup>69</sup> Vendim nr. 71, dt. 02.05.2023; Vendim nr. 72, dt. 02.05.2023;

<sup>70</sup> Shkresë nr. 6057/1 prot., dt. 30.06.2023

Për periudhën objekt monitorimi, ka rezultuar se KAS ka vendosur pushimin e shqyrtimit administrativ për 8 raste<sup>71</sup>, si psh kur ‘denoncuesi’ ka hequr dorë nga ankimi, ose kur denoncuesi nuk ka plotësuar elementët formalë të kërkesës ankimore pas plotësimit të afatit të lënë në dispozicion, duke mos treguar interes për vijueshmërinë e shqyrtimit administrativ.

---

<sup>71</sup> <https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-99-date-11.05.2023-Pushim-K.A-57.pdf>

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-112-date-15.05.2023-Kerkesa-28-pushim-shqyrtimi.pdf>

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-118-date-19.05.2023-Pushimi-K.A-62-PUK-Lezhe.pdf>

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/06/Vendim-nr.-119-date-22.05.2023-Pushimi-shqyrtim-ka-61-PLL-Tirane.pdf>

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-133-date-24.05.2023-Pushimi-K.A-69-naci-lato-1.pdf>

<https://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2023/05/Vendim-nr.-134-date-24.05.2023-Pushimi-K.A-72-Lame-Jaupaj.pdf>

Vendim nr. 167, datë 30.05.2023 “Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 89, datë 25.05.2023, të depozituar nga Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet”.

Vendim nr. 173, datë 02.06.2023 “Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 92, datë 27.05.2023, të depozituar nga ‘Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet’”.

1. KShH vlerëson se në zgjedhjet e ardhshme është e nevojshme të rritet pro-aktiviteti i KQZ-së në fillimin e hetimeve administrative me nismën e tij, çka do të kërkonte një rregullim më të qartë dhe të plotë në dispozitat e Kodit Zgjedhor. Sugjerojmë rishikimin e Kodit Zgjedhor me synim parashikimin e dispozitave të veçanta lidhur me afatet e hetimit administrativ, të cilat duhet të jenë më të shpejta, si dhe të përcaktojnë qartësisht mjetet e kërkimit të provës përgjatë hetimit administrativ të shqyrtimit të shkeljeve të veçanta administrative.
2. KShH vlerëson se sistemi i trajtimit të ankesave/denoncimeve nga KQZ duhet të forcohet me qëllim garantimin e standarteve më të mira për hetime efektive në afate të arsyeshme, objektive dhe të gjithëanshme. Në mënyrë të veçantë nevojitet të rritet besimi i sinjalizuesve në radhët e publikut pranë KQZ-së. Gjithashtu, ne vlerësojmë se Kuvendi duhet të mbështesë nga pikëpamja buxhetore, ngritjen e një strukture të specializuar hetimore pranë KQZ-së lidhur me këto denoncime.
3. Duke konsideruar fillimin e fushatës zgjedhore më herët se afati i përcaktuar në nenin 77 KZ, sugjerojmë rishikimin e nenit 91 KZ, duke e shtrirë ndalimin e përdorimit të burimeve publike, që prej datës së dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe mos e kufizuar atë në raport me faktin nëse një parti politike është regjistruar apo jo si subjekt zgjedhor.
4. Rekomandohet rritja e rolit proaktiv të KQZ-së për zbatimin e masave administrative në rastet kur subjektet zgjedhore e fillojnë fushatën zgjedhore përpara afatit të parashikuar në nenin 77 pika 1 KZ.
5. Në kuptim të zhvillimit të një hetimi të plotë, të gjithëanshëm dhe objektiv, nevojitet forcimi i bashkëpunimit midis KQZ-së dhe organeve publike, duke i ndëshkuar administrativisht këto të fundit kur nuk ofrojnë informacion/të dhëna në funksion të procesit të hetimit administrativ si dhe inkurajohet KQZ të përdorë edhe ekspertizën e jashtme në funksion të thellimit të hetimit administrativ, duke caktuar ekspertë teknikienë të fushës.
6. Rekomandojmë marrjen e masave konkrete nga ana e KQZ-së për garantimin e transparencës së plotë e në kohë reale, të transkriptimit të procesverbaleve të mbledhjeve dhe vendimmarrjeve.
7. Rekomandojmë marrjen e masave nga ana e KQZ-së për informimin dhe ndërgjegjësimin e subjekteve zgjedhore, si dhe kandidatëve, për respektimin rigoroz të neneve 91 dhe 92 KZ, dhe aktet përkatëse të Komisionit Rregullator lidhur me to.
8. I sugjerojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe KAS, gjatë trajtimit të ankesave/denoncimeve për shpërdorimin e fondeve publike apo burimeve njerëzore, të disponojnë nëpërmjet vendimmarrjeve të mirë-motivuara, si në rastet kur denoncimet pranohen e sidomos kur ato refuzohen.
9. I sugjerojmë KQZ-së marrjen e masave me natyrë rregullatore që i shërbejnë pozitivisht procesit të hetimit administrativ, me qëllim identifikimin e personit përgjegjës për

raportimin e veprimtarisë publike në ndërfaqen e krijuar, e ngarkimit me përgjegjësi ligjore edhe të subjektit zgjedhor për llogari të të cilit publikimi realizohet.

10. I rekomandojmë KQZ-së, për aq sa është e mundur të harmonizojë praktikën e masave administrative të caktuara ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike. Në këtë këndvështrim, vlen të theksohet se personat përgjegjës duhet të përfshihen në procesin e hetimit administrativ, në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor.
11. I sugjerojmë KQZ-së krijimin e praktikave të drejta sa i përket nevojës për garantimin e konfidencialitetit të rasteve të sinjalizuara nga denoncues që kanë zgjedhur të mbeten anonimë, në raport me të dhëna të tjera që i shërbejnë transparencës së çështjes dhe objektit të saj, por nuk e cenojnë anonimatën e sinjalizuesve.
12. Në rastet e konstatimit të elementëve të lidhur me përgjegjësinë penale, bazuar në nenin 281/3 K.Pr.Penale, KQZ duhet të rrisë rolin e tij proaktiv në referimin e rasteve në Prokurori, bazuar në auditimet e shpenzimeve financiare dhe financat e partive politike, ose shpërdorimin e aseteve publike.
13. Duke synuar garantimin e parimit të ndëshkueshmërisë proporcionale në raport me shkeljen e kryer, në mungesë të një praktike të unifikuar për shkak të vakuimit ligjor përcaktues i indikatorëve orientues të masës së gjobës, i sugjerojmë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë marrjen e masave për rishikimin e neneve 171 dhe 172 KZ, për të bërë një ndarje më të qartë të shkeljeve që janë të rënda, të cilat duhet të sanksionohen duke përcaktuar sanksione të drejta dhe proporcionale, që i shërbejnë efektivisht parandalimit dhe dënimit të autorëve të tyre, nga shkeljet e tjera jo të rënda apo të lehta.
14. I rekomandohet Kuvendit rishikimi i pikës 5 të nenit 171 KZ në raport me pjesën 2 të Kodit, edhe sa i përket shmangies së përsëritjes së mbi shkeljet që kryhen specifikisht nga Komisionerët e zgjedhjeve dhe sekretarët e KQV dhe KZAZ, si dhe adresimit të paqartësive lidhur me shkeljet që kryhen individualisht nga anëtarët e organeve drejtuese të KQZ-së, të cilët në fakt mandatohen nga Kuvendi.
15. I rekomandohet Kuvendit rishikimi i nenit 171 KZ sa i përket qartësisht të termit “pas marrjes dijeni” me qëllim konsiderimin e organizimit kompleks që kanë partitë politike. Rekomandohet zgjerimi i rrethit të subjekteve përgjegjëse për kryerjen e shkeljeve, duke e shtrirë fushëveprimin edhe për ato subjekte jo të regjistruara si parti politike por shpërdorues të aseteve publike për qëllime zgjedhore.
16. Duke konsideruar elaborimin në nenin 91 KZ vetëm të konceptit të “përdorimit të burimeve publike” dhe jo të “shpërdorimit”, i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë marrjen e masave për amendimin e Kodit Zgjedhor me qëllim adresimin e boshllëqeve, sa i përket mungesës së përcaktimit të saktë të termave “përdorim” “keqpërdorim” dhe “shpërdorim”.
17. Pavarësisht se përfaqësuesit e organeve drejtuese të KQZ-së sugjeruan që shkeljet e Kodit Zgjedhor të artikuloohen në mënyrë të qartë në dispozitat e këtij Kodi, përtej nevojës që mund të ekzistojë në këtë drejtim, përcaktimi i diapazonit të shkeljeve në



mënyrë shteruese në vlerësimin e KShH-së mund të jetë pengues, si rrjedhojë e sofistikimit të vazhdueshëm të shkeljeve të legjislacionit zgjedhor. KShH i rekomandon Kuvendit që në kuadër të reformës zgjedhore, të realizojë ndryshime të kujdesshme, të studiuara dhe konsultuara, me qëllim që të parashikohen dispozita që ruajnë një balance midis qartësisë dhe mosparashikimit në mënyrë shteruese në Kod të shkeljeve që sanksionohen në rrugë administrative.

- 18.** Me qëllim garantimin e parimit të sigurisë juridike e zgjidhjeve efektive, sugjerojmë mbajtjen në konsideratë nga organet drejtuese të KQZ-së të krijimit të praktikave vendimmarrëse që i shërbejnë pozitivisht standardeve të uniformizuara dhe respektimin e standarteve apo precedentëve të vendosur me vendimmarrje përfundimtare nga një instancë më e lartë (KAS në rastin e Komisionerit dhe Kolegji Zgjedhor Gyqësor në rastin e KAS).